REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
01 Nr. Br. 400/01 - 14894/24
05.07. 2024
Dragash - Dragaš

Kuvendi Komunal Dragash

Skupstina Opstina Dragash

Municipal Assembly Dragash

Për: **Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Nga: **z. Bexhet Xheladini, Kryetar i Komunës së Dragashit**

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

**Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit**

| Nr | Komponenta e auditimit (kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë | Zyrtari/ët përgjegjës | Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Çështja C1 - Rritje e efikasitetit në dhënien me qira të pronave komunale | Sipas nenit 1 pika 1 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, cek "Ky ligj ka për qëllim të siguroj shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme të komunës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, rritjen e vlerës së pronës së paluajtshme të komunës dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm kurse neni 8 pika 1 "Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet përmes procedurave | Kryetari edhe me tutje duhet të siguroj mekanizma dhe të marr veprime për shfrytezimin dhe menaxhimin efektiv të pronave komunale. | Komuna ka ndërmarrë këto masa:<br><br>1.Publikimi i listës së pronave, lista e përgjithshme dhe lista e veçantë(linku në webfaqen e komunës).<br><br>2.Përgatitja e rregullores për dhënien në shfrytëzim të pronave | Kryetari i Komunës, Drejtoriati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim | 10.01.2024 deri në vitin 2025 | Te gjitha pronat komunale që janë në shfrytëzim kanë kontrata të vjetra. Këto prona janë dhënë në shfrytëzim qysh para viteve 2000, në këto prona toka është e komunës ndërsa objekti i shfrytëzuesit. Komuna ju ka dërguar çdo vit shkresa dhe njoftime për shfrytëzimin e |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të 1.1 ankandit publik; 1.2 shprehjes së interesit; dhe 1.3 negociatave të kryetarit të komunës".<br><br>Komuna e Dragashit gjatë vitit 2023 ka marr vendime dhe ka nxjerr akte nënligjore për menaxhim më të mirë të pronave të saj. Si rezultat i këtyre veprimeve gjatë vitit 2023 janë dhënë në shfrytëzim mbi 80% e pronave komunale. Megjithatë, për menaxhim dhe shfrytëzim efektiv të pronave komuna duhet të luaj një rol aktiv. | | komunale më pak se 1 vit.<br><br>3.Komuna duhet të ripërtrijë kontratat me shfrytëzuesit të cilëve ju ka skaduar afati i kontratës sipas rregullores. | | | pronës të cilat janë të nenshkruara nga shfrytëzuesit që do të thotë se janë të pajtimit për shfrytëzimin e pronës dhe i ka ngarkuar me borgjin dhe vitin që janë duke e shfrytëzuar. Komuna do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm në mënyrë që borgjlinjtë të bëjnë pagesën e borgjit ndaj komunës. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Çështja A1 - Vonesa në pagesën e obligimeve | Neni 37.2 dhe neni 39 i LMFPP, përcakton që ZKF i OB është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose obligimeve tjera në SIMFK brenda tre (3) ditëve të punës pas pranimit të faturës, si dhe të sigurojë që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.<br><br>Obligimet e papaguara për vitin 2023 në total arrijnë shumën prej 112,423.28€ që krahasuar me vitin paraprak ka rritje prej 64,370.36 €. Bartje të obligimeve të papaguar kemi vërejtur edhe në përiudhën paraprake. Fatura për furnizim me pajisje tjera në vlerë prej 9,909.90 €, e pranuar në dhjetor 2022 ishte paguar në shkurt të vitit 2023. | Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha faturat e pranuara të regjistrohen brenda afatit dhe obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh. | Të veprohet sipas rregullores së obilgimeve dhe procedurave të thesarit. | Kryetari i Komunës, ZKF, të gjithë Drejtorët dhe zyrtarët finaciarë. | 01.01.2024<br>deri<br>01.10.2024 | Ky rekomandim është duke u zbatuar. Janë marrë të gjitha masat që most ë ketë vonesa në pagesën e obligimeve. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Vonesa në pagesën e saj ishte 50 ditë.<br><br>Sipas zyrtareve të komunës dhe shpalosjeve në PVF obligimet nuk janë paguar për shkak të mungesës se mjeteve, mbylljes së vitit fiskal si dhe neglizhencë e zyrtarit autorizues dhe zotues të programeve dhe nënprogrameve buxhetore etj. | | | | | |
| 3 | Çështja B1 - Mangësi në evidentimin e pasurisë | Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". Po ashtu sipas nenit 22 paragrafi 1,2,3 të rreg. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore. | Kryetari me qëllim të prezantimit të plotë dhe të saktë të pasurive në PFV duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e komunës janë të regjistruara në regjistra përkatës, është aplikuar zhvlerësimi si dhe është hartuar një raport i përgjithshëm për inventarizimin e pasurive që përmban gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes dhe | Do të bëhet regjistrimi i pasurisë nën 1000€ në mënyrë fizike dhe elektronike pasi që momentalishtë nuk funksionon sistemi i e-Pasuria.<br><br>Regjistrimi i pasurisë do të bëhet për të gjitha linjat e | Kryetari i komunës, si dhe të gjitha drejtoritë perkatëse dhe Zyrtari i Pasurisë. | 10.01.2024 deri ne fund të vitin 2024 | Regjistrimi mementalishtë është vetëm për Administratën Komunale.<br><br>Regjistrimi i pasurisë mbi 1000€ është funksional dhe zbatohet plotësishtë për tërë organizatën buxhetore. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.<br><br>Komuna kishte formuar komisione për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe komisionet i kishin hartuar raporte individual të pasurive nën 1,000 € për cdo njësi organizative të komunës dhe një raport të përmbledhur për pasuritë mbi 1,000 €, mirëpo nuk kishin përgatitur një raport të përgjithshëm të inventarizimit.<br>Po ashtu komuna nuk ka arritur t'i regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1,000 € në e-pasuri dhe sipas | vëretjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara. | organizatës buxhetore.<br><br>Autorizohet Drejtori i ekonomis financave dhe zhvillimit që të bëjë regjistrimin me metodën lineare për pasurinë nën 1000€. | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zyrtarit të pasurisë në komunë kjo ka ndodhë për arsye se ky system është funksionalizuar nga gjysma e dytë e vitit 2023.<br><br>Në testimin e pasurive mbi 1,000€ nuk kemi vërejtur pasuri të cilat nuk janë regjistruar në SIMFK, ndërsa pasuritë nën 1,000 € janë prezantuar në PFV në vlerë totale prandaj, nuk ishte e mundur të identifikohej se cilat pasuri ishin regjistruar dhe a është përllogaritur zhvlerësimi i tërë pasurisë. Pjesën e pasurive që nuk kanë arritur ta regjistrojnë në SIMFK e kishin regjistruar në kopje fizike. Pasuritë nën 1,000€, të prezentuara në PFV për vitin 2023 ishin 1,426,625.67 €, me një rritje krahasuar me vitin e kaluar për 1,104,835.67 €. | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Çështja B4– Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme | Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjete (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës se fundit për pages, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. | Kryetari duhet të siguroj se po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes se efikasitetit në mbledhjen e te arkëtueshmeve dhe të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitoreve të cilët nuk i përmbushin obligimet. | Kryetari i Komunës, Drejtoriati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim | Kryetari i Komunës, Drejtori për Ekonomi Financa dhe Zhvillim. | 01.06.2024 e deri ne vitin 2025 | Gjatë vitit 2023 u është dërguar shkresa të gjithë shfrytëzueseve të pronave komunale duke përfshirë dhe të gjithë borgjlinjët që kanë mbi 500 euro borgj nga tatimi ne pronë. Problem ka paraqitur mos prania e shumicës së borgjlinjëve në Kosovë. Gjatë vitit 2023 komuna ka ndërmarrë masa për inkasimin e borgjeve duke zbatuar vendimin e asamblesë komunale. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Komuna në PFV e vitit 2023 ka shpalosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 1,933,804.99 €. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,354,777.98 €, tatimi në tokë 325,655.89 € dhe shfrytezimi i prones komunale 253,371.12 €, të cilat janë rritur në krahasim me vitin 2022. Sipas zyrtarëve të komunës në këtë rritje ka ndikuar vendimi i datës 29 dhjetor 2022, i cili ka shtyrë afatin për ekzekutimin e vendimit për inkasimin e llogarive të arkëtueshme deri me 31.12.2023, për shkak të gendjes se rënde ekonomike të shkaktuar si pasojë e inflacionit global. | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Çështja A2 Mos kompletimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm | Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të audititmit të brendshëm në subjektin e sektorit public, neni 5.1.1 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë se paku tre auditor.<br><br>Niesia e Auditimit te Brendshem në Komunën e Dragashit, përbëhet vetëm nga Udhëheqësi i Njësisë se auditimit dhe nuk ka anëtar tjerë si auditor të brendshëm. Komuna nuk ka ndërmarre veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e përberjës dhe funksionit të Njësisë se Auditimit të brendshëm për ta kompletuar me staf të duhur. | Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshem sipas rregullores për themelimin e saj, e që njqkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme. | Kryetari i komunes dhe Udheqja e njesis së auditimit të brendshem | Kryetari i komunes dhe Udheqja e njesis së auditimit të brendshem | 01/06/2024<br>deri 2025 | |

Kryetari i Komunës së Dragashit

Bexhet Xheladini

04.07.2024